

"Fusha e Arsimit te Larte European "

Deklarate e Perbashket e Ministrave Europiane te Arsimit

Mbajtur ne Bolonje ne 19 Qershor, 1999

[Deklarata e Bolonjes eshte firmosur nga Ministrat e Arsimit te 29 vendeve Europiane me rastin e Konfederates/CRE te Konferences se Rektoreve EU, mbajtur ne Bolonje 18-19 Qershor, 1999.]

Ne saje te arritjeve te jashtezakonshme te viteve te fundit, Procesi European, eshte bere nje realitet konkret dhe aktual per Bashkimin dhe qytetaret e saj. Perspektiva te gjera me lidhje me te thella me vendet e tjera Europiane, i japin dimensione me te gjera ketij realiteti. Nderkohe, ne jemi deshmitare per nje rritje te ndergjegjesimit ne pjese te medha te botes politike dhe akademike dhe ne opinionin publik, te nevojës per te ndertuar nje Europe me te plote, ne veçanti ne ndertimin dhe forcimin e dimensioneve te saj intelektuale, kulturore, sociale, shkencore dhe teknologjike.

Nje Europe e Dijeve njihet sot gjeresisht si nje faktor i pazevendesueshem per rritje sociale dhe njerezore dhe si nje komponent i domosdoshem per te konsoliduar dhe pasuruar qytetarine Europiane, e afte per t'iu dhene qytetareve kompetencat qe u nevoiten per te perballuar sfidat e mileniumit te ri, sebashku me dijeni per vlera te perbashketa dhe qe i perkasin nje hapësire te perbashket sociale dhe kulturore.

Njihet boterisht perparësia e rendesise se arsimimit dhe bashkepunimit arsimor ne zhvillimin dhe forcimin e shoqerive te qendrueshme, paqesore dhe demokratike, veçanerisht duke patur parasysh situaten ne Vendet e Europes Juglindore.

Deklarata e Sorbonne ne 25 May, 1998, qe mbeshetetej nga keto konsiderata, theksoi rolin qendror te Universiteteve, ne zhvillimin e dimensioneve kulturore Europiane. Ajo theksoi krijimin e fushes Europiane te arsimit te larte, si nje rruge kyç, per te nxitur levizshmerine e qytetareve dhe mundesite per punesim si dhe zhvillimin e pergjithshem te Kontinentit.

Disa vende Europiane kane pranuar ftesen per tu angazhuar ne arritjen e objektivave te percaktuara ne deklarate, duke e firmosur ate ose duke shprehur aprovimin e tyre ne parim. Drejtimi qe kane disa reforma te arsimit te larte qe kane filluar nderkohe ne Europe, ka provuar vendosmerine e shume Qeverive per te vepruar.

Nga ana e tyre, institucionet e arsimit te larte European kane pranuar sfiden dhe kane marre nje rol kryesor ne ndertimin e fushes Europiane te arsimit te larte, veçanerisht ne ndjekje te parimeve themelore te parashtruara ne Bologna Magna Charta Universitatum ne vitin 1988. Kjo eshte e nje rendesie mjaft te madhe, duke marre parasysh se pavaresia dhe autonomia e Universiteteve sigurojne qe arsimi i larte dhe sistemet kerkimore t'i pershtaten vazhdimisht nevojave ne ndryshim, kerkesave te shoqerise dhe perparimeve ne dijet shkencore.

Kursi është vendosur në drejtimin e duhur dhe me synim të arsyeshëm. Arritja e pajtueshmërisë me të madhe dhe krahsimit të sistemeve të arsimit të lartë kërkon vull të vazhdueshëm për tu arritur plotësisht. Në duhet ta mbështesim atë nëpërmjet të inkurajimit të masave konkrete për të arritur hapa reale përpara.

Mbledhja e 18 Qershorit pati pjesëmarrjen e eksperteve autoritative dhe shkollareve nga të gjitha vendet tona dhe na pajisi në mënyjë sugjerime tepër të dobishme mbi iniciativat që duhet të ndërmerren.

Në duhet të vëzhgojmë, në veçanti, objektivin e rritjes së konkurrencës ndërkombëtare të sistemeve Europiane të arsimit të lartë. Vitaliteti dhe efikasiteti e çdo qytetërimi mund të matet me thirrjen që kultura e tij i bën vendeve të tjera. Në duhet të sigurojmë që sistemi Europian i Arsimit të lartë të marrë përmasat e shkallës të një gjëresie-boterore të tërheqjes të barabartë ndaj traditave tona të jashtëzakonshme kulturore dhe shkencore.

Ndërsa pohojmë mbështetjen tonë ndaj parimeve të përgjithshme të shtruar në deklaratën e Sorbonne, në përfshihemi në ko-ordinimin e politikave tona për të arritur në një afat të shkurtër, dhe në çdo rast brenda dekadës së pare të milenimit të pare, objektivat e mëposhteme, të cilat në i konsiderojmë të një rëndësie paresore në vendosjen e fushës Europiane të arsimit të lartë dhe në nxitjen e sistemit Europian të arsimit të lartë kudo në botë.

- Adoptimi i një sistemi të gradeve shkencore të njohura me lehtësi dhe të krahasueshme, gjithashtu përmes Plotesimit të Diplomave, me qëllim që të nxitet aftësia për punësim e qytetarëve Europiane dhe konkurrenca ndërkombëtare e sistemit Europian të arsimit të lartë.
- Adoptimi i një sistemi kryesisht të bazuar në dy cikle kryesore, universitare dhe të diplomuar me grada shkencore. Përdorimi i ciklit të dytë do të kërkojë plotësimin e sukseshëm të ciklit të pare të studimeve, që zgjat në një minimum prej tre vjetësh. Grada shkencore që jepet mbas ciklit të pare do të njihet në tregun Europian të punës si një nivel i përshtatshëm kualifikimi. Cikli i dytë do të çojë në titullin master dhe/ose doktorate si në shumë vende Europiane.
- Vendosja e sistemit të krediteve –të tilla si sistemi ECTS – si një mjet i përshtatshëm për nxitjen e levizshmërisë me të gjere të studentëve. Kreditet mund gjithashtu të përftoheshin dhe në kontekstin e arsimit jo-të lartë, duke përfshirë të mesuarit gjate gjithë jetës, duke siguruar që ato të njihen nga Universitetet e interesuara.
- Nxitja e levizshmërisë duke kapërcyer pengesat drejt të ushtruarit të efektshëm të levizjes së lire, me vëmendje të veçantë ndaj:
 - Për studentet, mundësi për studim dhe trainim dhe shërbime që lidhen me to,
 - Për mesuesit, kërkues dhe staf administrativ, njohje e periudhave të harxhuara në konkurimet kërkimore Europiane, mesimdhënie dhe trainim, pa paragjykuar të drejtat e tyre statutoare.
- Nxitja e bashkëpunimit Europian në sigurimin e cilësive me synim zhvillimin e kritereve dhe metodologjive krahasuese.
- Nxitja e dimensioneve të nevojshme Europiane në arsimin e lartë, veçanërisht në lidhje me zhvillimin e kurrikulës, bashkëpunimit ndër-institucional, skemave të levizshme dhe programeve të integruara të studimit, trainimit dhe kërkimit.

Ne ndermarrim arritjen e ketyre objektive – brenda kuadrit te kompetencave tona institucionale dhe respektimit te plote te diversitetit te kulturave, gjuheve, sistemeve te arsimit kombetar dhe autonomise se Universitetit – per te konsoliduar fushen Europiane te arsimit te larte.

Per arritjen e ketij qellimi, ne do te ndjekim rruget e bashkepunimit nder-qeveritar, sebashku me ato te organizatave jo-qeveritare Europiane me kompetence arsimin e larte. Ne presim qe Universitetet te pergjigjen perseri menjehere dhe pozitivisht dhe te kontribuojne aktivisht ne suksesin e perpjekjeve tona.

Te bindur se krijimi i fushes Europiane te arsimit te larte kerkon mbeshtetje te vazhdueshme, supervizim dhe pershtatje ndaj nevojave vazhdimisht evoluese, ne vendosem te takohemi perseri brenda dy vjetesh me qellim qe te vleresojme progresin e arritur dhe hapat e reja qe duhet te nermerrren.

Caspar Einem, Minister i Shkences dhe Transportit – Austria

Gérard Schmit, Drejtor i pergjithshem Komunitetit Francez, Minister i Arsimit te Larte dhe Kerkimit – Belgium

Jan Adé, Drejtor i Pergjithshem, Minister i Komunitetit Flamish, Dept i Arsimit – Belgjike

Anna Maria Totomanova, Zevendes-Minister i Arsimit dhe Shkences – Bullgari

Eduard Zeman, Minister i Arsimit, Rinise dhe Sporteve – republika Çeke

Margrethe Vestanger, Minister i Arsimit – Danimark

Tonis Lukas, Minister of Arsimit Minister i Arsimit – Estoni

Maija Rask, Minister Minister i Arsimit dhe Shkences – Finland

Claude Allègre, Minister i Arsimit Kombetar, Kerkimit dhe Teknologjise – France

Çolf-Michael Catenhusen, Sekretar Parlamentar Shteti, Ministra Federale e Arsimit dhe Kerkimit– Germany

Ute Erdsiek-Rave, Ministeri Arsimit, Shkences, Kerkimit dhe Kultures I Schlesçig-Holstein

Gherassimos Arsenis, Minister i Arsimit Publik dhe Maredhenieve Fetare – Greçi

Adam Kiss, Nen-Sekretar i Shtetit per Arsimin e Larte dhe Shkencen– Hungari

Gudridur Siguardardottir, Sekretar I Pergjithshem, Ministria e Arsimit, Shkences dhe Kultures – Island

Pat Daçling, Oficer Drejues, Minister I Arsimit dhe Shkences – Irland

Ortensio Zecchino, Minister of University and Scientific and Technological Research – Italy

Tatjana Koke, Minister Shteti i Arsimit te Larte– Latvia

Kornelijus Platelis, Minister i Arsimit dhe Shkences – Lituania

Erna Hennicot-Schoepges, Minister I Arsimit Kombatar dhe Trainimit Profesional – Luksemburg

Louis Galea, Minister i Arsimit – Malta

Loek Hermans, Minister i Arsimit, Kultures dhe Shkences – Hollande

Jon Lilletun, Minister i Arsimit, Kerkimit dhe Maredhenieve Kishtare – Norvegji

Çilibald Çinkler, Nen-Sekretar i Shtetit te Arsimit Kombetar – Poloni

Eduardo Marçal Grilo, Minister i Arsimit– Portugali

Andrei Marga, Minister i Arsimit Kombetar– Rumani

Milan Ftáčnik, Minister i Arsimit –Republika Sllovake

Pavel Zgaga, Sekretar Shteti i Arsimit te Larte – Sllovenia

D. Jorge Fernandez Diaz, Sekretar Shteti i Arsimit, Universiteteve, Kerkimit dhe Zhvillimit – Spain

Agneta Bladh, Sekretar Shteti i Arsimit dhe Shkences –Suedi

Charles Kleiber, Sekretar Shteti i Arsimit dhe Kerkimit – Konfederata Sviceriane

Baroness Tessa Blackstone of Stoke Neçington, Minister i Shtetit per Arsimin dhe Punesimin–Angli

Translated by: Adriana Bisha

Perkthyer nga: Adriana Bisha

Translation was enabled by SEE ECN.

Perkthimi u mundesua nga SEE ECN.